


## Inflacioni mujor, vjetor në përqindje (%) në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor për periudhën Janar Mars 2026

Ky material paraqet një përmbledhje të normave të inflacionit për tre muajt e parë të vitit 2026, duke u fokusuar veçanërisht në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Raporti evidenton një trend rritës të çmimeve të konsumit në mars 2026 krahasuar me vitin paraprak, te të gjitha vendet e rajonit, i nxitur kryesisht nga shtrenjtimi i energjisë, karburanteve dhe shërbimeve të transportit, gjithëashtu faktorët gjeopolitikë dhe luhatjet në tregjet ndërkombëtare kanë ndikuar në koston e jetesës dhe në zinxhirët agro-ushqimorë.

Sipas publikimit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dt. 10 prill 2026, IHÇK-Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte **më i lartë për 6,7 %** në muajin mars 2026, krahasuar me muajin mars 2025. Inflacioni mujor ishte 1,5 % në muajin mars 2026.

Figura 1. Normat mujore të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Nga grafiku shihet se gjatë periudhës janar mars 2026, kemi një trend rritës të Indeksit të çmimeve të konsumit (IHCK) **me një mesatare vjetore prej 6.2%** (në janar 5.8 %, në shkurt 6.0% dhe në mars 6.7%) krahasuar me muajt përkatës të vitit 2025.

Ngritja e indeksit të çmimeve të konsumit në mars 2026, është vërejtur te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (42,5%), biletat e fluturimeve (38,4%), furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (31,9%), energjia elektrike (17,4%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (17,4%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (15,6%), pushime të organizuara (13,2%), pemët (13,1%), mishi (12,4%), kafja, çaji dhe kakao (7,8%), shërbimet hoteliere (6,9%), prodhimet ushqimore (6,8%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (5,7%), shërbimet ambulatore

(5,6%), kujdesi personal (5,2%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (5,1%), perimet (4,9%), gjërat personale (4,4%), buka dhe drithërat (4,1%), duhani (4,1%), pijet alkoolike (3,9%), produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje (3,9%), mobilje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dysHEMEJE (3,8%), veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht (3,8%), mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit (3,4%), qumështi, djathi dhe vezët (3,4%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (2,7%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (2,3%), veshje (2,2%) dhe ndryshimet e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të disa nëngrupe me një ndikim të vogël në IHÇK me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 6,7 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve (mars 2026) vërehet te grupi i COICOP-it: energjia elektrike (-3,7%) dhe lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (-2,2%) me një ndikim prej -0,2 për qind në IHÇK-it.

**Tabela 1. Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në %, për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it,** <sup>1</sup>

COICOP Grupe dhe nëngrupet	Peshat 2026 në %	III - 2026 2015=100	III - 2026 II- 2026	III- 2026 III- 2025
00. IHÇK total	1,000.00	142.6	1.5	6.7
01. Ushqime dhe pije joalkoolike	327.6	164.2	0.4	6.5
02. Pije alkoolike, duhan	57.6	151.2	-0.1	4.0
03. Veshje dhe këpucë	42.6	113.8	0.2	1.7
04. Banesa, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera	94.1	143.4	-1.8	15.2
05. Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinë të shtëpisë	77.7	128.9	0.1	2.9
06. Shëndeti	29.6	126.4	-0.3	4.6
07. Transporti	186.2	130.9	8.1	10.5
08. Mjete Komunikimi	30.8	111.7	0.0	-0.5
09. Rekreacion dhe kulturë	40.5	109.7	0.0	1.5
10. Arsimi	8.3	107.0	0.0	-0.3
11. Restorante dhe hotele	43.1	145.9	0.1	6.7
12. Mallra dhe shërbime të ndryshme	61.8	126.7	0.1	3.2

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Nëse analizoim faktorët që kanë pasuar ndikim me tendin e inflancioni në nivelin regional, nga të dhënat e disponueshme për vendet e Ballkanit Perëndimorë, mund të vrehet një rritje e inflacionit të këto vendet gjatë tremujorit të parë (TM1 2026), veçanërisht në Kosovë dhe Maqedonin e Veriut vrehet rikthim i presioneve inflacioniste në muaj mars. Kjo e ndikuar kryesisht nga ndërveprimi i

<sup>1</sup> COICOP paraqet, Classification of Individual Consumption According to Purpose, (Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit),

faktorëve si “rritja e kostos” dhe “kërkesa” në raport të drejtpërdrejtë në disa nga komponentët e COICOP-it.

Më poshtë paraqitet tabela me normat e inflacionit për 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor (WB6) për vitin 2025 (mesatarja) dhe muajt e parë të vitit 2026, dhe përshkrim i disa nga faktorët kryesorë lidhur me grupet dhe nëngrupet përkatëse të COICOP-it.

**Tabela 2. Normat të inflacionit (ndryshimi në % krahasuar me të njëjten periudhë/muaj të vitit paraprak),**

Shteti (WB6)	2025 (mesatare vjetore)	Janar 2026	Shkurt 2026	Mars 2026
<b>Kosovë</b>	<b>3.9%</b>	5.8%	6.0%	6.7%
<b>Maqedoni e Veriut</b>	<b>4.1%</b>	3.2%	2.9%	4.9%
<b>Serbi</b>	<b>3.8%</b>	2.4%	2.5%	2.8%
<b>Bosnjë e Hercegovinë</b>	<b>4.0%</b>	3.6%	3.3%	3.5%
<b>Mal i Zi</b>	<b>3.9%</b>	2.9%	2.6%	3.1%
<b>Shqipëri</b>	<b>2.2%</b>	2.3%	2.5%	2.6%

*\*Shënim: Të dhënat për mesataren vjetore 2025 dhe tremujorin e parë të vitit 2026 bazohen në parashikimet dhe trendet e raportuara nga Statista, dhe të dhënat e fundit të publikuara nga institucionet e vendeve përkatëse.*

Disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në trendin rritës të inflacionit të lidhur me grupet dhe nëngrupet përkatëse të COICOP-it janë:

### 1. Rritja e çmimeve të energjisë dhe karburanteve, si një nga faktor dominues në TM1 2026,

- ✓ Në Europë, inflacioni në mars 2026 u rrit kryesisht për shkak të energjisë (+4.9%), i nxitur nga zhvillimet gjeopolitike dhe tregjet e naftës/gazit.
- ✓ Energjia ka efekt shumë të shpejtë në inflacion (përmes kostove të prodhimit dhe transportit). Rritja e çmimeve gjatë marsit (sidomos në Kosovë dhe RMV), të grupet dhe nëngrupet: 04. Banesa, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera kanë pasur ndikim të gjërë në ekonomi (si rishikimi i tarifave komunale: psh. në Kosovë dhe disa pjesë të Bosnjës, janë miratuar tarifa të reja për ujë dhe energji elektrike, ku në Kosovë furnizimi me ujë shënoi rritje deri në 33.4% në fillim të vitit); dhe 07. Transporti, 07.2 Karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal; (çmimi i drurit dhe peletit ka mbetur i lartë, duke prekur kryesisht familjet në Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut; karburantet e transportit: luhatjet në tregun ndërkombëtar të naftës, të ndikuara nga tensionet gjeopolitike, sollën një goditje të fortë në mars 2026, p.sh. në Kosovë rritja ishte e lartë, për këtë kategori).

### 2. Inflacioni i ushqimeve dhe presionet në zinxhirin agro-ushqimor,

- ✓ Inflacioni i ushqimeve në OECD<sup>2</sup> u rrit në fillim të 2026, i lidhur me tregjet e paqëndrueshme dhe zinxhirët e furnizimit nga këto vende.

<sup>2</sup> Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) përbëhet nga 38 vende anëtare, kryesisht ekonomi të zhvilluara me të ardhura të larta, të përkushtuara ndaj demokracisë dhe ekonomive të tregut.

✓ Rajoni i Ballkanit ndikohet fortë nga importet dhe luhatshmëria e çmimeve bujqësore. Rritja e çmimeve të grupet dhe nëngrupet (01. Ushqime dhe pije joalkoolike dhe 02. Pije alkoolike, duhan), sidomos në Kosovë është shumë konsistente me inflacion të lartë të ushqimeve, që ka peshë të madhe në shportën e konsumit.

### 3. Rritja e çmimeve të shërbimeve,

✓ Inflacioni bazë sikur në shumë ekonomi edhe te disa vendet e Ballkanit Perëndimor (si RMV dhe Shqipëri, rritja në mars) është nxitur nga shërbimet dhe rritja e të ardhurave reale, Rritja e çmimeve të grupet dhe nëngrupet (08. Mjete Komunikimi, 09. Rekreacion dhe kulturë, 11. Restorante dhe hotele dhe 12. Mallra dhe shërbime të ndryshme).

### 4. Efektet e transportit dhe kostove të importit (inflacioni i importuar),

✓ Rritja e kostove të transportit dhe kufizimet tregtare (p.sh. tensionet në zinxhirët agro-ushqimorë) rrisin çmimet,  
 ✓ Inflacioni në vendet e vogla të hapura (si WB6) është shumë i ndjeshëm ndaj importeve, Rritja e çmimeve të grupet dhe nëngrupet (07. Transporti, 07.3 Shërbimet e transportit të pasagjerëve, 03. Veshje dhe këpucë dhe 05. Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinë të shtëpisë). Ky faktor shpjegon faktin pse vende me trend inflacion më të ulët (si Shqipëri, Serbi,) kanë rritje graduale dhe jo rënie/ngritje të fortë.

Figura 2. Normat e inflacionit për 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor (WB6) për vitin 2025 (mesatarja) dhe muajt e parë të vitit 2026

